



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

NJOFTIM I DATËS 13.09.2024

**PËR SHPALLJEN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimet nr. 489, dhe nr. 490, datë 13.09.2024, ka vendosur:

- hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për 2 (dy) pozicione të lira të përhershme në fushën e të drejtës civile.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimet nr. 491, nr. 492, dhe nr. 493, datë 13.09.2024, ka vendosur:

- hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për 3 (tre) pozicione të lira të përhershme në fushën e të drejtës penale.

Me këto vendime Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shpallur kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për lëvizjen paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:

Çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë, në një pozicion të komanduar ose në skemë delegimi, i cili plotëson kriteret ligjore për lëvizjen paralele në pozicionin e lirë për të cilin është hapur procedura, të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për lëvizjen paralele në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përcaktohen në nenin 8, pika 3, në nenin 43, pika 2, shkronja “a”, “c” dhe pika 6, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:

- a) Kandidati gjatë 5 pesë viteve të fundit, duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale si gjyqtar në fushën e së drejtës përkatëse ku do aplikojë;

- b) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur;
- b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopje të kartës së identitetit;
- ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- dh) fotokopje të vlerësimeve etike dhe profesionale, në rast se ka.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues është deri më datë 20.09.2024

Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë”, Tiranë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimet e tij nr. 489 deri nr. 493 datë 13.09.2024.

Kujdes:

- *Në zbatim të pikës 5 të nenit 43 dhe pikës 6 të nenit 48 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije se:*
- Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, qofshin këto procedura ngritje në detyrë apo procedura lëvizje paralele, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës.
- Në rast të kandidimit në më shumë se tre pozicione të lira ngritje në detyrë e lëvizje paralele në proces, kandidati duhet të ri konsiderojë kandidimet e tij duke hequr dorë nga aplikimet e mëparshme përpara se të vijojë me aplikimet e reja të shpallura me vendimet nr. 489- nr. 493 datë 13.09.2024, duke përcaktuar tre pozicionet për të cilat vijon kandidimin.

- **Mos përcaktimi i tyre nga vetë kandidati, passjell identifikimin e vullnetit të tij në bazë të kohës së kandidimeve, duke filluar nga ai i bërë më parë ose, në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, në bazë të radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë.**